



MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT DHE I BASHKËPUNIMIT

lidhur në mes të

AUTORITETI I KONKURENCËS I REPUBLIKËS SË KOSOVËS (AKRK)

dhe KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE (KPM)

Për bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve të përbashkëta në fushat përkatëse të palëve nënshkruese të zhvilluara në Republikën e Kosovës

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME


Neni 1 Fushëveprimi

Ky Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi është hartuar me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës (AKRK) dhe Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM). Memorandumi bazohet në paragrafin 1 të nenit 64 të Ligjit Nr. 08/L -056 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe si i tillë është shprehje e vullnetit të mirë dhe dëshirës së palëve nënshkruese të këtij memorandumi për të nxitur bashkëpunimin në fushën e hetimeve të shkeljeve, çrregullimeve dhe shtrembërimit të konkurrencës në Kosovë, si dhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe, bazuar në parimet e barazisë dhe të përfitimit reciprok.

Neni 2 Shkëmbimi i informacionit

AKRK dhe KPM shkëmbejnë informacionin e nevojshëm, të cilin pala marrëse e ruan me të njëjtin nivel konfidencialiteti, si pala dërguese.

-Shkëmbimi i informacioneve bëhet sipas përcaktimeve në ligjet respektive të konkurrencës dhe mediave.



-Angazhimi reciprok për hartimin e akteve nënligjore dhe ligjore në fushat respektive të mbuluara nga palët.

-Angazhimi në evitimin e rasteve të mundshme të kolizionit ligjor dhe akteve nën ligjore respektive.

-Procesi i shkëmbimit të informacionit do të bazohet në parimin e besueshmërisë reciproke, transparencës mes palëve për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi, efikasitetit në përsheptimin e kohës së shkëmbimit të informacionit dhe vullnetit pozitiv për të vënë në dispozicion informacionin e disponueshëm konform legjislacionit.

-Secila nga palët duhet të garantojë konfidencialitetin e marrë nga pala tjetër. Informacioni i marrë në kuadër të këtij memorandumi nuk mund të transferohet një pale të tretë, pa pasur një autorizim me shkrim nga pala e cila ka siguruar informacionin.

Neni 3 Përgjegjësitë e palëve

AKRK, në përputhje me përgjegjësitë që ka me aktet ligjore në fuqi, do të:

-Konsultojë dhe bashkëpunojë me KPM me rastin e ushtrimit të ndonjë mbikëqyrje të konkurrencës në fushën e mediave elektronike në përputhje me Ligjin për Konkurrencën;

-Informojë KPM lidhur me të gjitha ankesat e pranuar nga subjekte të ndryshme për dëmtimin e konkurrencës dhe shkeljen e ligjeve në fuqi;

-Informojë KPM me rastin e fillimit të ndonjë hetimi në përputhje me dispozitat relevante në fuqi;

-Merr parasysh rekomandimet e KPM kur një hetim apo studim i bazuar në dispozitat e Ligjit të Konkurrencës përfshirë sektorin e mediave. Në rast të mospajtit, AKRK duhet ta informojë KPM duke specifikuar qartë arsyet e mospajtit;

-Informojë KPM para marrjes së ndonjë vendimi në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi;

-Informojë KPM nëse vërtetohet se sjellja e një ndërmarrje/operatori do të ketë ndikim negativ në zhvillimin e sektorit, ekonomisë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës;

-Informojë KPM me rastet e tregjeve tjera, të cilat besohet se mund të kenë ndikim në sektorin e mediave.

KPM, në përputhje me përgjegjësitë që ka me aktet ligjore në fuqi, do të:

-Informojë AKRK me rastin e fillimit të procesit të analizës së tregjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi;

-Merr parasysh rekomandimet e AKRK me rastin e analizës së tregut dhe përcaktimit të ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg. Në rast të mospajtit, KPM duhet ta informojë AKRK duke specifikuar qartë arsyet e mospajtit;

-Konsultojë dhe bashkëpunojë me AKRK me rastin e miratimit të rregulloreve dhe akteve tjera normative me rëndësi kyçe për mbrojtjen e konkurrencës;

-Informojë AKRK nëse vërtetohet se sjellja e një ndërmarrje/operatori do të ketë ndikim negativ në zhvillimin e sektorit, ekonomisë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Grupet e përbashkëta të ekspertëve

Palët mund të formojnë grupe të përbashkëta pune sipas ekspertëve, sipas nevojës, ad-hoc, për aspektet e analizës së tregjeve, procedurave të inspektimit apo bashkëpunimit ndërinstitucional për çështje të karakterit të përbashkët sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Secila palë i bartë shpenzimet e veta lidhur me ekspertët e saj.

Neni 5

Koherenca e takimeve

Titullarët e palëve respektive do të takohen në rast nevoje për sa i përket implementimit të këtij memorandumit, në mënyrë që të rendisin prioritetet e bashkëpunimit brenda kësaj kornize dhe vazhdimin e tij, shkëmbim pikëpamjesh dhe ato sipas mundësive, do të ndërmarrin veprime dhe pozicione të përbashkëta në forume dhe organizata ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me sektorin e mediave.

Neni 6

Dispozitat përfundimtare

Asnjë ndryshim nuk mund t'i bëhet këtij memorandumit në mënyrë të njëanshme, përveç se me shkrim, si dhe pasi palët të kenë rënë dakord paraprakisht midis tyre dhe të kenë autorizuar ndryshimin nëpërmjet nënshkrimit nga titullarët e palëve.

Ky Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga AKRK dhe KPM dhe është i vlefshëm deri sa palët të kërkojnë me shkrim shfuqizimin ose shuarjen e tij ose imponimit të dispozitave të reja ligjore të miratuara nga legjislativi i vendit.

Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme i këtij memorandumit mund të bëhet në çdo kohë nga AKRK dhe KPM, por duke lajmëruar me shkrim 30 (tridhjetë) ditë më parë palën tjetër.


Memorandumit hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë pjesë e tij nuk është në tejkallim ose kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore mbi të cilat palët mbështesin ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre.

Palët zotohen të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë Memorandum për sa parashikohet në të. Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, secila nga palët mund të tërhiqet dhe të ndërpresë në mënyrë të njëanshme Memorandumin si është paraparë edhe me nenin 6.3.

Për lehtësimin dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm për zbatimin e këtij memorandum, palët bien dakord që të caktojnë personat dhe mënyrën e kontaktit midis tyre, në një afat prej 30 ditë nga dita e nënshkrimit.

Memorandumi i Mirëkuptimit, është i shkruar në gjuhën shqipe, në dy kopje, nga një për secilën palë, nënshkruhet dhe hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

AKRK


Neime Binaku-Isufi

Kryetare e AKRK-së

KPM


Jeton Mehmeti
Kryetar i Komisionit të KPM

